



Primitje Receipt	Procedura Procedure	17.01	2024	4	viti god year
Organ / Qendra Org./Unit	Id. Prot Id. Prot	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity		
SKPM/SHIC	312/2024		1/3		



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A nr.1475/2023

Këshilli i Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti -kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë me Rushit Kajtazi- Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës A.nr.1475/2023 të datës 05.12.2023 të parashtruar nga ankuesja

kundër organit të punësimit/Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 17.01.2024, mori këtë

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.1475/2023 e datës 05.12.2023 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Nëpunësja civile (tutje ankuese) e punësuar në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në pozitën, Drejtore e Departamentit të Politikave të Zhvillimit Rural sipas Akt Emërimit me numër protokollit 3603, të datës 10.12.2012, ndërsa e njëjta më datë 05.12.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër veprimit administrativ të zyrtarëve F.M dhe F.B të cilat kanë marrë kompetenca të eprorit (Sekretarit të Përgjithshëm) dhe kanë zbatuar urdhra të paligjshëm të dhënë nga Ministri dhe Këshilltarja F.M, përkatësisht vërejtjet me shkrim të datës 27.01.2023 nga Shefja e Kabinetit F.M dhe vërejtjet Ministrin të datës 31.01.23 dhe 19.06.2023, që i janë shqiptuar përmes Emalit zyrtar i janë vendosë në dosje personale të ankueses nga ana e Udhëheqëses së Personelit të këtij institucioni sipas urdhërësës së zyrtares F.B.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje referuar vetëm Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 11.12.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ndërsa kjo e fundit, më datë 15.12.2023 ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (tutje Kolegji i këshillit), pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkëngjitura të lëndës të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankueses **është e palejuar, sepse:**

Nga administrimi i provave materiale të lëndës rrjedhë se ankuesja është e punësuar në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, gjegjësisht e njëjti sipas Akt Emërimit me numër protokoll 3603, të datës 10.12.2012, mbanë pozitën "Drejtoresh në Departamentin e Politikave të Zhvillimit Rural", në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Me tej nga shkresat e lëndës rezulton se Ministri dhe Këshilltarja F.M, ankueses i kanë shqiptuar vërejtje me shkrim përmes emailit dhe at Shefja e Kabinetit F.M më datë 27.01.2023 ndërsa Ministri më datë 31.01.23 dhe 19.06.2023, rrethana të konfirmuara nga vetë ankuesja, ndërsa në lidhje me këto vërejtje të shqiptuara, bazuar në shkresat e lëndës konfirmohet se nuk ka pasur ndonjë ankesë nga ana e ankueses përkundër që vërejtjet kanë qenë përmes emailit dhe se ankuesja ka qenë e njoftuar me kohë për këto vërejtje.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në rrethanat e potencuara si më lartë ka konstatuar se ankuesja ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e ka parashtruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 127, paragrafi 1. të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se: "1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ", si dhe në kundërshtim me nenin 24, paragrafi 3 Ligjit Nr. 06/L -114 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se: "3. Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil sipas këtij ligji", prandaj Kolegji i këshillit ka konstatuar, se ankuesja kundër vërejtjeve të datës 27.01.2023, 31.01.23 dhe 19.06.2023 të dhëna nga zyrtarët e potencuar si më lartë ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil e ka parashtruar me datë 05.12.2023, me numër protokoll 1475/2023, e që është jashtë afatit të përcaktuar ligjor për parashtrimin e ankesave.

Ndërlidhur me ankesën e ankueses të parashtruar në Këshilli, Kolegji i këshillit, ka konstatuar se ankuesja ka qenë e obliguar që ankesën ta parashtronte në pajtim me Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Ligjin e aplikuar Nr. 06/L -114 për Zyrtarët Publikë, në afatin prej (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ, prandaj me qenë se ankesa është jashtë afatit ligjorë kolegji i këshillit nuk është lëshuar në shqyrtim të pretendimeve ankimore tjera të ankueses nga se nuk janë me relevancë për vendim ndryshe nga ky si është marrë përkatësisht si në dispozitiv të këtij vendimi.

Bazuar në të gjeturat si me lartë, Kolegji pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda, A.nr.1475 /2023, datë 17/01/2024

Rushit KAJTAZI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses,
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Bujqësisë Pylltarisë Dhe Zhvillimit Rural;
- Arkivit të KPMSHCK-së